

VENDIM
Nr.659, datë 25.9.2003

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I KANALIT TË UJËRAVE TË LARTA NË KOMUNËN KOTË,
VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorimin të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme të pronarëve të cilët preken nga ndërtimi i kanalit të ujërave të larta në komunën Kotë, Vlorë.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të komunës Kotë, Vlorë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi për sipërfaqet 2183 m² tokë truall, 1750 m² tokë bujqësore, 3002 m² sipërfaqe jonxhë, 27 rrënjë drufrutorë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 991 740 (dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dyzet) lekësh.
 4. Fondi prej 2 991 740 (dy milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e dyzet) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, të përballohet nga buxheti i vitit 2003, zëri "Investime" i miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale në shumën prej 223 000 (dyqind e njëzet e tre mijë) lekësh, të përballohet nga komuna Kotë, e cila do të kryejë edhe pagesën e pronarëve të shpronësuar.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda periudhës 1-15 tetor 2003.
 7. Punimet të përfundojnë brenda muajit dhjetor 2004.
 8. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe komuna Kotë, Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E KANALIT TË
UJËRAVE TË LARTA NË KOMUNËN KOTË, VLORË**

Nr	Emri Mbiemri	Sip/tokë bujqësore m ²	Çmim për m ²	Sip/tokë truall m ²	Çmim për m ²	Dru frutorë	Çmim	Hardhi rrënjë	Çmim	Jonxhë sip m ²	Çmimi për m ²	Vlera në total (lekë)
1	Trashëgimtarët e Memisha Myrtaj											
	Neki Myrtaj Hariz Myrtaj Feti Myrtaj Tefide Myrtaj Emine Dapaj Gjergji Myrtaj Perlat Myrtaj Enver Myrtaj Jahja Myrtaj			1833	900	11	2000			1257	20	1 696840
2	Enver Muhamed Myrtaj			350	900	11	2000	16	3000			385 000
3	Perlat Muhamet Myrtaj	525	500							525	20	273 000
4	Bilbil Shefit Likaj	350	500							350	20	182 000
5	Astrit Haxhi Memaj	875	500							870	20	454 900

Gjithsej
991740